

NR. REP.
NR. KOL.

AKT-THEMELIMI
(Për krijimin e shoqërisë tregëtare)

Sot, në _____, më datë 02.03.2016 (dymijë e gjashtëmbëdhjetë), ditën e _____,

- 1. Ardjan TAKAJ**, i biri i Petrit dhe i Mete, me datëlindje 05.04.1963, lindur dhe banues në Tiranë, adresa Rr. Sulejman Delvina, Nr. 31, posedues i letërnjoftimit shqiptar me Nr. 029149247, Nr. Cel: +355692022576, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
- 2. Bashkia Korçë**, njësi e qeverisjes vendore, me seli në Korçë, adresa Rruga "28 Nëntori" Korçë, ligjërisht e përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë, Z. Sotiraq FILO, shtetas shqiptar, me datëlindje 23.06.1971, lindur në Korçë, posedues i letërnjoftimit shqiptar me Nr. BD7335833, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Ligjin Nr. 9376, datë 21.04.2005, "Për Sportin", i ndryshuar, Ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjin Nr. 9879, datë 21.02.2008 "Për Titujt", Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 1718, datë 24.12.2008 "Për procedurat e transformimit të klubeve sportive në shoqëri aksionare dhe për kriteret e përcaktimit të kapitalit themeltar", subjektet e paraqitura përpara meje personalisht,

VENDOSËN:

Të themelojnë Klubi i Futbollit Skënderbeu sh.a, shkurt KF Skënderbeu sh.a.

Bazuar në legjislacionin shqiptar përkatës në fuqi, subjektet themelues të Klubit të Futbollit Skënderbeu sh.a, më kërkuan të hartoj këtë akt – themelimi, i cili sanksionon parashikimet vijuese:

Neni 1

Forma juridike, Kohëzgjatja dhe Selia

- Klubi i Futbollit Skënderbeu sh.a është shoqëri aksionare, me ofertë private, e cilësuar si shoqëri sportive në mbështetje të Ligjit Nr. 9376, datë 21.04.2004 "Për Sportin", i ndryshuar; Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar.
- Klubi i Futbollit Skënderbeu sh.a krijohet për një kohëzgjatje të pacaktuar.
- Në të gjitha aktet që do të nxjerrë organizata kundrejt të tretëve apo në aktet e brendshme do të shënohet emërtimi "KLUBI I FUTBOLLIT SKËNDERBEU SH.A", ose shkurtimisht akronimi "KF SKËNDERBEU SH.A".



4. Selia e Klubit të Futbollit Skënderbeu sh.a. ndodhet në Rr. Gjergj Dimitrov, Stadiumi "Skënderbeu", Korçë, Shqipëri.

Neni 2

Qëllimi i KF Skënderbeu sh.a

KF SKËNDERBEU SH.A. është njëshoqëri tregtare, me qëllim fitimi, e cila synon të zhvillojë aktivitet në sportin e futbollit dhe rritjen e vlerave sportive për sportin e futbollit.

Neni 3

Objekti

Shoqëria aksionare do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- Organizimin e aktiviteteve në fushën e sportit të futbollit dhe pjesëmarrjen në garat sportive të organizuara nga Federata Shqiptare e Futbollit, si dhe pjesëmarrjen në garat sportive të organizuara nga UEFA, për meshkuj e femra;
- Organizimin e aktiviteteve në fushën e sportit të futbollit, beach – soccer dhe pjesëmarrjen në garat sportive vendase e ndërkombëtare;
- Krijimin e Akademisë së Futbollit Skënderbeu, ku përfshihen të gjitha ekipet zinxhir të sportit të futbollit;
- Futja në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të shit-blerjes së lojtarëve;
- Kuotimi në indekset e bursave kombëtare apo ndërkombëtare;
- Aktivitete të tjera në fushën e sportit të futbollit;
- Çdo aktivitet tjetër në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 4

Kapitali themeltar

1. Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë në vlerën 4,550,000.00 (katër milion e pesëqind e pesëdhjetë mijë) Lekë, i ndarë në 4,550 (tre mijë e pesëqind) aksione të zakonshme me vlerë nominale 1,000.00 (një mijë) Lekë secili. Aksionet e themeluesve në kapitalin e shoqërisë janë në përputhje me kontributin e tyre të mëposhtëm:
 - a) Aksionari Z. Ardjan TAKAJ, lloji i kontributit: **PARA**, numri i aksioneve 3,412.5 (tre mijë e katërqind e dymbëdhjetë pikë pesë) dhe vlera nominale e aksioneve do të jetë 1,000.00 (një mijë) Lekë, me një vlerë kontributi: 3,412,500.00 (tre milion e katërqind e dymbëdhjetë mijë e pesëqind) Lekë.
 - b) Aksionari Bashkia Korçë, lloji i kontributit: **PARA**, numri i aksioneve 1,137.5 (një mijë e njëqind e tridhjetë e shtatë pikë pesë) dhe vlera nominale e aksioneve do të jetë: 1,000.00 (një mijë) Lekë; me një vlerë kontributi: 1,137,500.00 (një milion e njëqind e tridhjetë e shtatë mijë e pesëqind) Lekë.
2. Numri i përgjithshëm i aksioneve do të jetë: 4,550 (katër mijë e pesëqind e pesëdhjetë); kapitali i regjistruar: 4,550,000.00 (katër milion e pesëqind e pesëdhjetë mijë) Lekë; vlera e paguar: 4,550,000.00 (katër milion e pesëqind e pesëdhjetë mijë) Lekë.

Neni 5

Organet e shoqërisë

Organet e shoqërisë aksionare janë:



1. Asambleja e Përgjithshme;
2. Këshilli i Administrimit;
3. Administratori/administratorët.

Neni 6

Asambleja e Përgjithshme

1. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë:
 - a) përcaktimin e politikave tregtare;
 - b) ndryshime të statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e anëtarëve të këshillit të administrimit;
 - d) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - e) miratimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" e "d" të kësaj pike;
 - f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - g) shpërndarjen e fitimeve vjetore;
 - h) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
 - i) pjesëtimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;
 - j) ndryshime në të drejtat, që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta;
 - k) përfaqësimin e shoqërisë në gjykimet ndaj organeve të administrimit;
 - l) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - m) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;
 - n) çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statuti.
2. Asambleja e përgjithshme merr vendime pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse, së bashku me raportin e këshillit të administrimit dhe raportin e ekspertit kontabël të autorizuar.
3. Nëse shoqëria zotërohet nga një aksionar, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga aksionari i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga aksionari i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet e mëposhtme:
 - a) miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - b) shpërndarja e fitimeve vjetore dhe mbulimi i humbjeve;
 - c) zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit;
 - d) vendimet për investime;
 - e) riorganizimi dhe prishja e shoqërisë.
4. Vendimet e paregjistruara në regjistrimin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.
5. Vendimet e Asamblesë së përgjithme që kanë lidhje me çështet e përcaktuara në pikën 1 gërmat i) dhe l) të mëren me unanimitet.
6. Vendimet e Asamblesë të cilat kanë efekt mbi buxhetin e aksionarit Bashkia Korçë janë të vlefshme vetëm me miratimin nga ana e këtij aksionari.

Neni 7

Këshilli Administrimit

1. Asambleja e Përgjithshme cakton tre ose më shumë, por jo më shumë se 21, persona fizikë si anëtarë të Këshillit të Administrimit, në pajtim me shkronjën "c", pika 2 të nenit 135 dhe pikën 2 të nenit 155 të Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar. Emërimet do të jenë individuale dhe në përputhje me vendimin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicë votash, i cili, nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si anëtar të Këshillit të Administrimit. Anëtarët e Këshillit të Administrimit mund të shkarkohen nga detyra në çdo kohë nga Asambleja e Përgjithshme, pa cenuar të drejtat që burojnë nga një kontratë pune e lidhur me Shoqërinë.



2. Mandati i Anëtarëve të Këshillit të Administrimit është 3 (tre) vjeçar dhe fillon nga momenti i marrjes së vendimit nga ana e Asamblesë së përgjithshme.
3. Shumica e anëtarëve të Këshillit të Administrimit do të jenë të pavarur dhe nuk do të jenë Administratorë, në përputhje me parashikimet e pikës 1 dhe 4 të nenit 155 të Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.
4. Anëtarët e Këshillit të Administrimit mund të caktojnë një person i cili dëshiron të veprojë në cilësinë e anëtarit të Këshillit të Administrimit, duke pasur parasysh se emërimi nuk përbën zmadhim të numrit të anëtarëve, të përmendur në pikën 1 të këtij neni. Anëtarit i Këshillit të Administrimit i emëruar në këtë mënyrë do të jetë në detyrë deri në mbledhjen vjetore vijuese të Asamblesë së Përgjithshme.
5. Personat e mëposhtëm emërohen si anëtarë të Këshillit të Administrimit të Shoqërisë deri në zgjedhjen e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme, sipas shkronjës "c", pika 2 të nenit 135 të Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar:
 - a) Z. Elmoz Tahaj, i biri i Petit dhe i Hetes, me datëlindje 13.12.1957, lindur në Tirouë dhe banues në Tirouë, në adresën Rr. 3 Beshiruarët Nr. 100, Cel: 0664033248, posedues i letërnjoftimit shqiptar me Nr. 027 888602, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
 - b) Z. Perikli Karavello, i biri i Alexit dhe i disisë, me datëlindje 26.12.1956 lindur në Kovajë dhe banues në Tirouë, në adresën Rr. Jerald Bejzou, Pall 54/4 shk. I op 8 Cel: 0666040772, posedues i letërnjoftimit shqiptar me Nr. _____, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
 - c) Z. Aslind Boshku, i biri i Kristop dhe i diola, me datëlindje 07.07.1985 lindur në Tirouë dhe banues në Durrës, në adresën N. 11 Rr. Baki Cela Nr. 33, Cel: 0672077866, posedues i letërnjoftimit shqiptar me Nr. BB 5036 152, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
 - d) Z. Shkumbin Qarnuevli, i biri i Urrou dhe i Gëzime me datëlindje 09.07.1981, lindur në Hopëdoui dhe banues në Hopëdoui në adresën _____ Cel: _____, posedues i letërnjoftimit shqiptar me Nr. K004 1871, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
 - e) Z. Flis Pesmeti, i biri i Poucheli dhe i Urroui, me datëlindje 13.11.1968, lindur në Korcë dhe banues në Korcë, në adresën _____ Cel: 0692107142, posedues i letërnjoftimit shqiptar me Nr. G 8111 3104H, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
6. Në rast se njëri prej anëtarëve të Këshillit të Administrimit dorëhiqet nga kryerja e funksionit të tij, vendin vakant deri në vendimarrjen e Asamblesë së përgjithshme e mbulon Administratori.

Neni 8

Administratorët

1. Këshilli i Administrimit zgjedh një ose më shumë persona fizikë si Administratorë dhe përfaqësues të Shoqërisë për një periudhë 3 (tre) vjeçare, në pajtim me nenin 158 të Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar. Emërimet do të jenë individuale dhe sipas një vendimi të Këshillit të Administrimit, i cili, nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si Administrator. Administratorët mund të shkarkohen në çdo kohë nga detyra, pa cënuar të drejtat që burojnë nga një kontratë pune e lidhur me shoqërinë.
2. Anëtarët e Këshillit të Administrimit mund të caktohen si Administratorë për sa kohë që shumica e anëtarëve të Këshillit të Administrimit përbëhet nga persona të pavarur që nuk ushtrojnë kompetenca administrimi.

3. Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorët e parë të Shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Këshillit të Administrimit të zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme, në përputhje me shkronjën "c", pika 2 të nenit 135 të Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.
4. Politikat tregtare të Shoqërisë do të administrohen dhe Shoqëria do të përfaqësohet nga Administratorët të cilët mund të ushtrojnë të gjitha kompetencat e tyre në përputhje me parashikimet e pikës 3 dhe 5 të nenit 158 dhe nenin 159 të Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar. Detyrat e Këshillit të Administrimit, në përputhje me parashikimet e shkronjave "b", "c", "ç", "d", "dh", "e", "ë", "f", "g" dhe "i" të pikës 1 të nenit 154 të Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, nuk mund t'iu delegohen Administratorëve.
5. Ndryshimet e statutit nga Asambleja e Përgjithshme dhe të udhëzimeve të Këshillit të Administrimit nuk do të shfuqizojnë akte të mëparshme të Administratorëve, të cilat do të ishin të vlefshme nëse ndryshimi nuk do të ishte kryer ose udhëzimi nuk do të ishte dhënë.
6. Administratori i parë i shoqërisë aksionare do të jetë Z. Gerhard Takaj

Neni 9

Mbulimi i humbjeve

1. Humbjet e mundshme të krijuara nga aktiviteti tregtar i shoqërisë përgjatë një viti ushtrimor ose të bartura, do të mbulohen nga aksionarët në përputhje me raportin e pjesëmarrjes në kapitalin themeltar.
2. Vendimarrja për mbulimin e humbjeve do të merret në përputhje me nenet 14, 15, 16, 17, 18 të këtij statuti.
3. Mbulimi i humbjeve nga ana e aksionarëve mund të kryhet përmes zmadhimit ose zvogëlimit të kapitalit themeltar, përmes rritjes së shpenzimeve vjetore (buxhetit vjetor), emetimit të obligacioneve ose titujve të ndryshëm, ose në çdo formë tjetër të njohur me ligj.
4. Aksionari, Bashkia Korçë do të marrë pjesë në mbulimin e humbjeve të shoqërisë në masën 25 % por në çdo rast jo më shumë se vlera e miratuar me Vendim të Këshillit të Bashkisë Korçë në buxhetin vjetor për këtë qëllim.

Neni 10

Të tjera

1. Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë aksionare do të bëhet në përputhje me dispozitat e legjislacionin shqiptar në fuqi dhe nga Statuti i KF Skënderbeu sh.a.
2. Aksionarët e shoqërisë mund të vendosin për pjesëmarrjen e shoqërisë në aktivitete të tjera tregtare, ndarjen, tjetërsimin apo prishjen e shoqërisë.
3. Çdo mosmarrëveshje e mundshme ndërmjet palëve do të zgjidhen me mirëkuptim. Në të kundërt, kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë.

Akti i themelimit pasi u gjet i përputhshëm me vullnetin paraprak të aksionarëve themelues, u nënskrua përpara meje me vullnetin e tyre të lirë.

Ky akt-themelimi hartohet në katër kopje të njëjta në gjuhën shqipe.

Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve

AKSIONARËT:

Z. Ardjan TAKAJ

Ardjan Takaj
(Emër, Mbiemër, Firmë)

BASHKIA KORÇË

Ligjërisht e përfaqësuar nga Kryetari :

Z. Sotirag FILO

Sotirag Filo
(Emër, Mbiemër, Firmë, Vullë)